



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Më datë 26.07.2017, Mekanizmi Parandalues Nacional – MPN, realizoi vizitë të paparalajmëruar në Stacionin Policor me Kompetencë të Përgjithshme Vallandovë.

Vizita e ekipit të MPN në SP Vallandovë u realizua në kuadër të mandatit të Avokatit të Popullit - Mekanizmit Parandalues Nacional i cili buron nga Protokollin Fakultativ ndaj Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Johumane, Nënçmuese ose Ndëshkuese dhe nga Ligji për Avokatin e Popullit. Me Protokollin Fakultativ përkufizohet se MPN-ja realizon vizita të rregullta në vendet ku personat privohen nga liria, me qëllim të identifikimit të rreziqeve për shkak të parandalimit të torturës ose llojeve tjera të trajtimeve brutale, jonjerëzore, nënçmuese ose ndëshkuese.

Ekipi i MPN-së kishte bashkëpunim dhe kooperim të mirë nga ana e personave zyrtarë të punësuar në Stacionin Policor Vallandovë, të cilët mundësuan qasje papengesë në të gjitha hapësirat dhe instalimet, si dhe këqyrje mbi dokumentacionin e kërkuar.

Ekipi i MPN-së, konstatoi se nëpunësit zyrtarë organizojnë trajnime të rregullta dhe të vazhdueshme me tema dhe përmbajtje të ndryshme.

Ekipi i MPN-së konstatoi se Evidenca në SP Vallandovë është e saktë, e qartë dhe në rregull. Në librat e evidencës të cilat mbahen për tre vitet e fundit, nuk është përdorur fare korrektori dhe vërehet rrjedha kronologjike e ngjarjeve të evidentuara.

Ekipi i MPN-së konstatoi se në SP Vallandovë nuk ka hapësirë të posaçme për marrje në pyetje të personave të privuar nga liria, ndërkaq gjithashtu konstatoi se SP Vallandovë nuk ka hapësirë të posaçme për biseda dhe ndalimin e personave të mitur, në përputhje me Ligjin për të drejtat e fëmijëve.

Ekipi i MPN-së vuri në dukje se në hyrjen e SP Vallandovë nuk ka rampë të aksesshme për personat me aftësi të kufizuar, me çka këtyre personave u vështirësohet qasja në Stacionin policor.

Ekipi i MPN-së vuri në pah se hapësirat e ndalimit janë në një gjendje jashtëzakonisht të keqe materiale dhe nuk i përmbushin standardet minimale të parapara për ndalimin e personave.

Ekipi i MNP-së konstatoi se ekziston praktikë negative e ndalimit në SP Vallandovë, të cilët janë transferuar nga SP Gjevgjeli për shkak të mungesës së udhëheqëseve të turnit, edhe pse hapësirat për ndalim në SP Vallandovë nuk i përmbushin standardet për ndalimin e personave.

Gjithashtu, asnjëra nga hapësirat, në të cilat kryhet marrja në pyetje e personave të arrestuar dhe personave të privuar nga liria nuk disponojnë me sistem për audio ose video monitorim.

Për këtë vizitën Mekanizmi Parandalues Nacional hartoi Raport të posaçëm në të cilin i konstatoi gjendjet pozitive dhe negative dhe adresoi rekomandime konkrete deri te Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe deri te komandanti i Stacionit Policor në SP Vallandovë, me qëllim që të eliminohen mangësitë e konstatuara dhe të përmirësohen kushtet sa i përket trajtimit të personave të privuar nga liria dhe personave të arrestuar dhe të ndaluar.